

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1808/4 Prot

Durrës, më 24.07.2025

V E N D I M

Nr. 67, datë 24/07 2025

PËR

"MIRATIMIN E TARIFËS SË STUDIMIT, PËR PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMIT PËR PROGRAME TË INTEGRUARA TË STUDIMIT SI DHE PËR PROGRAMET E STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL 2 - VJEÇAR NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 3 "*Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë*", pika 3/ç ku citohet se: "*Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës për të përcaktuar tarifën e studimit, në përputhje me këtë ligj*"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 288, datë 21.05.2018 "*Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë*", të ndryshuar; Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës; Vendimet respektive të Bordit të Administrimit për miratimin e tarifave të studimit, si dhe në relacionin Nr. 1721 prot., datë 11.07.2025 të Drejtorisë së Administrimit Financiar, vendimit të Senatit Akademik nr.82, datë 21.07.2025, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e tarifave të studimit, për studentët të cilët regjistrohen, në një program të ciklit të parë të studimeve, pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, për vitin akademik 2025-2026, sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët të cilët regjistrohen për herë të parë, në vitin e parë në një program studimi të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, me kohë të plotë, për vitin akademik 2025 – 2026, do të paguhet nga studentët në masën 50% të vlerave të pasqyruara në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Studentët, të cilët studiojnë brenda kohës normale të studimit dhe nga viti akademik pararendës, rezultojnë me notë mesatare 6 - 8.99 dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike, për vitin akademik 2025 – 2026, të paguajnë 50 % të tarifës vjetore të shkollimit, të pasqyruar në tabelën nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.